



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1151/1 Prot.

Tiranë, më 06 . 11 . 2023

V E N D I M

Nr. 226 , datë 06 . 11 . 2023

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 226 Regj., datë 23.10.2023, të shtetasit L. J, kundër Bashkisë Peshkopi, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “racës” dhe “gjendjes shoqërore”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Subjekti ankues, shtetasi L. J, në shpjegimet e paraqitura para Komisionerit, është shprehur se, problematika e tij konsiston si më poshtë citohet:

“Jam baba i dy fëmijëve, me nënën e të cilëve jam divorcuar. Të dy fëmijët m'i ka lënë Gjykata mua me vendim, për rritje e kujdes. Vajza ka moshën 15 vjeç dhe djali 13 vjeç. Djali është i sëmurë me prapambetje mendore dhe për këtë sëmundje merr 11900 lekë në muaj. Jam paraqitur tek Shërbimi Social pranë Bashkisë Peshkopi për të kërkuar ndihmë ekonomike për fëmijët e mi, por ata më kanë thënë se nuk mund të përfitoj sepse unë bashkëjetoj me një zonjë e cila ka dy fëmijë me ish-bashkëshortin e saj. Zonja në fjalë merr ndihmë ekonomike për dy fëmijët e saj. Zyra e Shërbimit Social, me këtë pretendim më thotë që mua nuk më takon të përfitoj ndihmë ekonomike pasi i merr bashkëjetuesja. Unë nuk jam dakord me këtë përgjigje sepse ne thjesht bashkëjetojmë dhe kemi fëmijë me prindër të ndryshëm. Jam i papunë sepse kujdesem për djalin që kam të sëmurë me prapambetje mendore.”

¹ Në vijim do t'i referohemi me akronimin: KMD.

Në përfundim, subjekti ankues, ka kërkuar nga Komisioneri marrjen e masave që ai të jetë përfitues i ndihmës ekonomike nga ana e Bashkisë Peshkopi.

Pas shqyrtimit paraprak të ankesës së depozituar pranë Komisionerit, u konstatua se ajo kishte mangësi të anës formale, në lidhje me dokumentacionin e kërkuar dhe për këtë arsye, nëpërmjet e-mail-it datë 25.10.2023, KMD, i ka kërkuar subjektit ankues të plotësojë dokumentacionin, apo të parashtrijë fakte e prova lidhur me provueshmërinë e aplikimit të tij pranë strukturave përkatëse të Bashkisë, për tu klasifikuar si përfitues i ndihmës sociale.

Në përgjigje të kërkesës të mësipërme, duke qenë se ankuesi nuk iu përgjigj e-mailit të dërguar, u telefonua nga inspektori i çështjes. Referuar bisedës telefonike të zhvilluar mes inspektorit dhe ankuesit², rezultoi se ai ka deklaruar se nuk ka bërë asnjë aplikim dhe nuk ka paraqitur ndonjë kërkesë pranë Bashkisë Peshkopi, dhe se të gjitha komunikimet mes tyre kanë qenë verbale.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: “Çdo dallim, përgjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstron se viktima e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur.

² Sipas procesverbalit të mbajtur nga inspektori i çështjes, me datë 30.10.2023, ora 16:20

Nga këqyrja e analizimi i dokumentacionit të dërguar pranë KMD-së, rezulton se:

- Bazuar në të dhënat e Certifikatës Familjare, lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile nr. 32, Njësia Administrative Peshkopi, me datë 19.10.2023, ankuesi është kryefamiljar, i divorcuar, me dy fëmijë. Përkatësisht: L. J e bija, e datëlindjes 13.05.2008 dhe M. J, i biri, i datëlindjes 29.08.2010.
- Referuar “Vërtetimit të vetëdeklarimit të përkatësisë etnike”, me nr. 293/4 prot., datë 10.10.2023, të lëshuar nga Kryetari i Shoqatës Kombëtare “Sfinksi”, ankuesi vetëdeklarohet si anëtar i pakicës egjiptiane.
- Ankuesi deklaron se i biri i dignostikuar me prapambetje të theksuar mendore është përfitues i ndihmës ekonomike në shumën prej 11900 lekësh në muaj, dhe se ai është i papunë dhe pa të ardhura të tjera financiare, gjë që e bën të pamundur që ai të kujdeset për dy fëmijët e tij minorene.
- Ankuesi deklaron se bashkëjeton me një një zonjë, e cila gjithashtu ka dy fëmijë minorene në kujtestari, pasi është e divorcuar nga ish-bashkëshorti.
- Ankuesi pretendon se, Bashkia Peshkopi e ka diskriminuar atë pasi nuk i ka dhënë ndihmën sociale për dy fëmijët e tij, ndërsa për rastin e bashkëjetueses e cila po ashtu ka dy fëmijë të vegjël në kujdestari e ka miratuar, duke prezumuar se meqë jetojnë bashkë ankuesi nuk mund të përfitojë.
- Megjithëse i është kërkuar në mënyrë të shprehur nga ana e KMD-së, ankuesi nuk ka depozituar asnjë dokument apo provë tjetër, lidhur me provueshmërinë e aplikimit të tij për ndihmën ekonomike pranë Bashkisë. Ankuesi ka deklaruar se komunikimi me punonjësit e Bashkisë ka qenë vetëm verbal.

Sa i takon pretendimit të ankuesit se është diskriminuar nga ana e Bashkisë Peshkopi, Komisioneri vlerëson se ankesa nuk duhet të pranohet pasi është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji, bazuar në arsyetimin vijues:

Subjekti ankues ka pretenduar që është diskriminuar nga ana e Bashkisë Peshkopi, duke mos e bërë përfitues të ndihmës ekonomike, për shkak të racës dhe gjendjes shoqërore, por nuk ka depozituar asnjë dokument apo provë tjetër pranë KMD-së, që të provojë se ka aplikuar për të qenë përfitues i ndihmës ekonomike që akordohet nga Bashkia.

Për tu bërë pjesë e listës së përfituesve të ndihmës ekonomike, duhet të ndiqen disa hapa proceduralë³, të parashikuar në legjislacioni përkatës që rregullon këtë shërbim.

Ligji nr. 9355, datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe Shërbimet Shoqërore”, i ndryshuar dhe VKM Nr. 787, datë 14.12.2005 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe masës së ndihmës ekonomike”, i ndryshuar kanë përcaktuar se, një ndër kategoritë përfituese të ndihmës ekonomike dhe të shërbimeve sociale janë edhe familjet pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme.

³ <https://portavendore.al/dialogmeqytetarin/kartelat-e-sherbimeve-te-bashkise/kujdesi-socialne/ofrimi-i-sherbimit-per-perfitimin-e-ndihmes-ekonomike/>

Në bazë të VKM nr. 955, datë 7.12.2016, aplikimi për tu futur në Skemën e Ndhmës Ekonomike bëhet në mënyrë elektronike.

Përgjegjësia për dhënien e këtij shërbimi është e njësisë vendore (Administratorit) ku aplikuesi ka vendbanimin.

Për të përfituar ndihmë ekonomike kryefamiljari, (së bashku me bashkëshorten kur ka një të tillë) nga data 1-10 të çdo muaji paraqiten pranë administratorit shoqëror të seksioneve të ndihmës dhe shërbimeve shoqërore në bashki/njësitë administrative për të aplikuar për ndihmë ekonomike si familje në nevojë me kopjen e kartës së identitetit të aplikantit dhe kopje të kartave të identitetit të anëtarëve të tjerë të familjes që kanë karta identiteti (për fëmijët certificate lindje) dhe dokumente të tjera të përcaktuara në aktet nënligjore.

Administratori, në prani të kryefamiljarit bashkëshortes, apo individëve plotëson on-line në sistem aplikimin për ndihmë ekonomike që përmbledhin informacionin për: demografinë e familjes, arsimin dhe punësimin; llojin e banesës; pasuritë/asetet shtëpiake; të ardhurat nga programet e mbrojtjes sociale. Është me shumë rëndësi që informacioni të jetë i saktë, pasi në rast të kundërt penalizohen familjet për deklaram të rremë.

Aplikimi bëhet nga data 1 deri 10 e çdo muaji. Vendimi për trajtimin me ndihmë ekonomike merret brenda muajit nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror nëpërmjet formulës së pikëzuar që merr parasysh karakteristikat e ndryshme strukturore të familjeve urbane dhe rurale.

Familjet, të cilat janë refuzuar se nuk kanë marrë pikët e mjaftueshme, kanë të drejtën e riaplikimit në muajt pasardhës dhe gjithashtu ruajnë të drejtën e ankimimit në lidhje me vendimin e marrë.

Ankimimi bëhet me shkrim fillimisht pranë njësisë vendore, e cila është e detyruar të kthejë përgjigje brenda 7 ditëve kalendarike nga marrja e ankesës. Pas ezaurimit të ankimimit të njësisë vendore, personi ka të drejtë të ankimojë tek Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror dhe në gjykatë. Për familjet aplikuese, të cilat nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit, bazuar në vlerësimin social-ekonomik, të kryer nga administratori shoqëror, Këshilli Bashkiak ka të drejtë të miratojë dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6% dhe/ose me fonde të tjera të buxhetit vendor.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri vëren se, ankuesi nuk ka provuar se ka aplikuar pranë strukturave të Bashkisë, madje ka deklaruar se ka patur vetëm komunikim verbal me punonjësit e saj, dhe në këto kushte, ai duhet të ndjekë hapat proceduralë për përfitimin e ndihmës ekonomike, fillimisht duke aplikuar për përfitimin e saj.

Nëse, pas paraqitjes së kërkesës së tij/aplikimit për ndihmën ekonomike pranë Administratorit Shoqëror të njësisë vendore të tij, ai nuk kualifikohet si përfitues dhe pretendon se diskriminohet për cilindo shkak të parashikuar në LMD, ai ka të drejtën e ankimimit pranë Komisionerit.

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta në nenin 18, si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Gjykata Kushtetuese në disa vendime të saj ka interpretuar nenin 18 të Kushtetutës, si dhe ka theksuar se parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në ligj dhe përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë por edhe në të drejtat e parashikuara nga ligjet e tjera në fuqi. Gjykata është shprehur se:

“Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëllajta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Barazia përpara ligjit dhe në ligj presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta”, si dhe “Vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme dhe objektive mund të përlligjet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë⁴.”

Neni 14 i Konventës Evropiane për Drejtat e Njeriut (KEDNJ), ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, ndërkohë që Protokollin 12-të të KEDNJ-së, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, ndalon diskriminimin në lidhje me “gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji” dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe se sa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se “diskriminimi” do të thotë që të trajtosh ndryshe pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, persona të cilët ndodhen në situata të ngjashme dhe diferenca në trajtim, nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, se trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim dhe nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet. Sipas GJEDNJ, e drejta për të mos u diskriminuar e garantuar nga KEDNJ, gjithashtu çënohet kur pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm shtetet dështojnë që të trajtojnë ndryshe personat situata e të cilëve objektivisht e ndryshme.

Ligji nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me një listë jo shteruese shkaqesh, duke parashikuar në mënyrë të ndrejtëpërdrejtë mbrojtjen nga diskriminimi respektivisht edhe për shkaqet e pretenduara nga ankuesja.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatesinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatesinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

⁴ Shih vendimet nr.39, datë 16.10.2007, nr. 4 datë 12.02.2010, nr. 34, datë 20.12.2015, të Gjykatës Kushtetuese.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: “Çdo dallim, përvijshim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Në thelb të diskriminimit, është trajtimi i diferencuar dhe më pak i favorshëm, i shfaqur qoftë në formën e dallimit, kufizimit, përvijshimit ose preferencës dhe që ka për bazë një nga shkaqet e mbrojtura nga ligji. Pra, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit garantohet vetëm për ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme që kanë për bazë një nga shkaqet e mbrojtura. Në mungesë të një shkakut të mbrojtur, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim i pafavorshëm konsiderohet diskriminim sipas ligjit. Gjithashtu, jo çdo diferencë në trajtim është diskriminim, por vetëm ato që nuk kanë një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm. Pra, nëse për diferencën në trajtim konstatohet se ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, atëherë trajtimi ndryshe është i përligjur dhe nuk është i ndaluar nga ligji.

Duke mbajtur në konsideratë standardet dhe parashikimet e mësipërme ligjore, Komisioneri vlerëson se, ankuesi nuk ka provuar pretendimet për diferencë në trajtim ose për dështimin nga ana e Bashkisë Peshkopi për të trajtuar rastin e tij, për shkak të situatës në të cilën ai gjendet, situatë e cila supozohet se ka si shkak racën dhe gjendjen shoqërore të tij.

Në lidhje me pretendimin për diskriminim për shkaqet sipërcituar, Komisioneri vlerëson se, vetëm fakti që një person posedon këto shkaqe, nuk mjafton për të ngritur një pretendim për diskriminim. Personi i cili pretendon se është diskriminuar për shkaqet e pretenduara, por jo vetëm, duhet të parashtrojë fakte nga të cilat mund të prezumohet se ka një diferencë në trajtim dhe se kjo diferencë në trajtim pretendohet se ka si bazë shkakun e mbrojtur.

Vendimmarrja e Komisionerit duhet të jetë e arsyetuar dhe e argumentuar mbështetur në bazueshmërinë e provave e fakteve në gjykim. Kjo, pasi një moment kyç në gjykimin administrativ është edhe procesi i provueshmërisë mbi faktet objekt verifikimi, gjykimi, mbi të cilat bazohet një vendimmarrje e drejtë.

Faktet që janë objekt i të provuarit merren për bazë për efekt provueshmërie, vetëm kur ato janë paraqitur me saktësi dhe në formën e kërkuar nga ligji gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës. Për të formuar bindjen e tij, organi administrativ, në këtë rast Komisioneri, duhet të

marrë parasysh si argumentet që flasin për ekzistencën e një fakti, ashtu dhe argumentet që flasin për mosekzistencën e tij.

Provat janë të dhëna që merren prej burimeve (subjektit ankues në këtë rast) dhe sipas rregullave të përcaktuara në ligj, të cilat vërtetojnë ose rrëzojnë pretendimet e palëve në proces (neni 11, i Kodit të Procedurës Civile).

Subjekti ankues i cili pretendon diskriminimin, ka detyrimin që të provojë me fakte, shpjegime e prova bindëse, nëpërmjet të cilave duhet të krijojë bindjen se mund të prezumohet diskriminimi.

Pala ankuese nuk parashtroi e depozitoi prova, fakte apo rrethana nga të cilat të mund të prezumohet se ka patur sjellje, veprime apo mosveprime të institucioneve përgjegjëse që të jenë motivuar nga shkaqet e pretenduara, pasi fillimisht ai duhet të plotësonte kërkesën minimale lidhur me provueshmërinë e paraqitjes së kërkesës ose aplikimit të tij pranë strukturave përkatëse të Bashkisë Peshkopi. Vetëm pasi ankuesi të provonte para KMD-së se ka paraqitur kërkesë apo aplikim për përfitimin e ndihmës ekonomike, atëherë Komisioneri mund të vihej në lëvizje për të kërkuar informacion lidhur me veprimet apo mosveprimet e strukturave të Bashkisë.

Për sa më sipër, referuar nenit 33 pika 4/ç të ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, i cili citon se: “*Ankesa nuk pranohet nëse është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim*”, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

Komisioneri i rekomandon subjektin ankues që, nga data 1-10, të çdo muaji, mund të paraqitet pranë Administratorit Shoqëror të seksionit të ndihmës dhe shërbimeve shoqërore në bashki/njësinë administrative përkatëse, për të aplikuar për ndihmë ekonomike me dokumentacionin e kërkuar, si familje me të ardhura të pamjaftueshme.

Nëse pas aplikimit të kryer, ankuesit mund t’i lindin pretendime për veprime apo mosveprime me natyrë diskriminuese karshi tij, për ndonjë nga shkaqet e parashikuara në LMD, nga ana e strukturave përgjegjëse të Bashkisë Peshkopi, lidhur me përfitimin e ndihmës ekonomike, atëherë ai mund t’i drejtohet Komisionerit me ankesë.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/ç, të ligjit nr.10 221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës së subjektit ankues L. J, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.

KOMISIONERI

Robert GAJDA